



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

Datë 09/11/2007

**Njoftim për shtyp**

**Mbi abuzimin me pozitën dominuese të “Albanian Mobile Communication sh.a.” dhe “Vodafone Albania sh.a.” në Tregun e Telefonisë së Lëvizshme**

Komisioni i Konkurrencës shqyrtoi çështjen e abuzimit me pozitën dominuese të shoqërive Albania Mobile Communication sh.a dhe Vodafone Albania sh.a në tregun e telefonisë së lëvizshme, ose shkelje të tjera të konkurrencës në këtë treg për periudhën 2004-2005.

Hetimi paraprak i Autoritetit i Konkurrencës filloi në Shtator të vitit 2005 dhe më 11 tetor 2005 Komisioni vendosi nisjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e telefonisë së lëvizshme në përgjithësi dhe veçanërisht në shoqëritë AMC sh.a dhe Vodafone Sh.a, përse i përket ekzistencës ose jo të abuzimit me pozitën dominuese ose shkelje të tjera të konkurrencës në këtë treg.

Në bazë të vendimit të Komisionit të Konkurrencës, Sekretariati ka kryer procedurat hetimore në përputhje me ligjin nr. 9121 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe Kodin e Procedurave Administrative. Në përfundim të këtij hetimi, Sekretariati ka paraqitur pranë Komisionit të Konkurrencës “Raportin e Hetimit të Thelluar”.

Në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, u organizuan seanca dëgjimore ku palët nën hetim kanë dhënë pretendimet e tyre mbi Raportin e Hetimit të Thelluar.

Mbi bazën e analizave të kryera mbi pjesët e tregut, pengesat e hyrjes në treg, konkurrenca potenciale, fuqia ekonomike e ndërmarrjeve, fuqia kundërvepruese e blerësve dhe karakteristikat e tjera të tregut, rezulton se kompanitë AMC dhe Vodafone kanë pozitë dominuese në tregun e telefonisë së lëvizshme.

Komisioni i Konkurrencës konstatoi se shoqëritë AMC dhe Vodafone kanë abuzuar me pozitën dominuese duke vendosur çmime të padrejta në tregun e telefonisë së lëvizshme dhe shkelur në këtë mënyrë nenin 9 të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Sipas ligjit një ndër format kryesore të abuzimit me pozitën dominuese është zbatimi i çmimeve të padrejta prej tyre.

Komisioni i Konkurrencës konstaton se, në mungesë të një modeli të kostos të detajuar të shërbimeve, mund të përdoret alternativa krahasuese (benchmark -u) të tarifës së shërbimit me ato të shërbimeve respektive, ose të ngjashme në rajon. Sipas “Cullen Report 2 – Country Comparative Report (2006) “Shqipëria përfaqëson një përjashtim në lidhje me çmimet, që e vendos atë midis vendeve me çmime më të larta të EU-së” .

Të dyja shoqëritë, AMC dhe Vodafone, kanë aplikuar tarifa për shërbimin me kartë për thirrjet brenda rrjetit dhe jashtë rrjetit, më të larta se sa mesatarja e rajonit.

Të dyja shoqëritë, AMC dhe Vodafone, kanë aplikuar tarifë terminimi kombëtar mbi dy herë më të lartë, krahasimisht me tarifën mesatare të terminimit të vendeve të rajonit.

Të dyja shoqëritë, AMC dhe Vodafone, kanë aplikuar tarifa për shërbimin me parapagim mesatarisht mbi dy herë më të larta se mesatarja respektive e vendeve të rajonit.

Të dhënat e paraqitura konfirmojnë që shoqëritë objekt hetimi kanë aplikuar tarifa më të larta se vendet e rajonit me nivel të Produktit të Brendshëm Bruto (GDP) dhe të ardhura për frymë të krahasueshme me Shqipërinë (p.sh Maqedonia).

Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës vendosi:

1. Shoqëritë AMC sha dhe Vodafone sha kanë abuzuar me pozitën dominuese duke vendosur çmime të padrejta në tregun të telefonisë së lëvizshme gjatë periudhës objekt hetimi (2004, 2005).
2. Për shkeljen e konstatuar në pikën 1, shoqëria Albania Mobile Communication sh.a. (AMC) gjobitet me 2 % të xhiros vjetore të produktit përkatës të vitit 2005, që e shprehur në vlerë është 211 552 000 lekë.
3. Për shkeljen e konstatuar në pikën 1, shoqëria Vodafone Albania sh.a. (Vodafone) gjobitet me 2 % të xhiros vjetore të produktit përkatës të vitit 2005, që e shprehur në vlerë është 242 633 000 lekë.
4. Ngarkohet Policia Tatimore për vjeljen e gjobave.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.